



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

01– Nr. 05-400-23798/12 .
Kaçanik; 27.09. 2012.

Në mbështetje të nenit 12.1 dhe 12.2(c) lidhur me nenin 40.2(a) dhe (g) të Ligjit nr.03/L-040 – Për Vetëqeverisjen Lokale, të nenit 11 të Ligjit Nr. 3/L-204 - Për Tatimin në Pronën e Paluajtshme në Kosovë, të datës 07.10.2010, të Ligjit Nr. 04/L-100 – Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Tatimin në Pronën e Paluajtshme Nr. 03/L-204, të nenit 2 dhe 9 të Ligjit nr.03/L-049 – Për Financat e Pushtetit Lokal si dhe të nenit 34.5 të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e mbajtur më datë: **27.09.2012**, e aprovoj;

R R E G U L L O R E N
PËR VENDOSJEN E TATIMIT NË PRONË NË TERRITORIN
E KOMUNËS SË KAÇANIKUT, PËR VITIN 2013

Neni 1.

Duke u bazuar në nenin 7. të Ligjit Nr. 04/L-100 - Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Tatimin në Pronën e Paluajtshme në Kosovë Nr. 03/L-204, në komunën e Kaçanikut për vitin 2012, shkallët (tarifat) e tatimit në pronën e paluajtshme në bazë vjetore do të jenë prej 0,15% deri 0,20%, më sa vijon:

P ë r s h k r i m i	Norma
1. Pronat Rezidenciale – shtëpi	0,15%
2. Pronat Rezidenciale – banesë / apartman	0,15%
3. Garazhat	0,15%
4. Pronat Komerçiale	0,20%
5. Pronat Industriale	0,20%
6. Pishinat	0,20%
7. Fushat sportive (të mbuluara)	0,20%
8. Pronat Bujqësore	0,15%
9. Pronat e papërfunduara	0,15%

Neni 2

Duke u bazuar në vendndodhjen e pasurisë (objekteve) e cila ndikon dukshëm në vlerën e saj, si dhe vlerësimeve nga Grupi punues, në Komunën e Kaçanikut janë të përcaktuar katër (4) zona, e të cilat paraqesin ndryshime të theksuara në vlerën e pasurisë.

Neni 3

3.1. Katër (4) zonat në territorin e komunës, të përcaktuara sipas kësaj rregullore, janë ndarë si më poshtë:

- Qyteti i Kaçanikut duke përfshirë edhe fshatin Bob, është i ndarë në tri (03) zona të vlerësimit, përkatësisht në Zonën e I, II dhe III-të;
- Zona e III-të përfshinë këto fshatra: Bajnicë, Begracë, Biçec, Doganaj, Duraj, Elezaj, Gabricë, Gajre, Gërllicë e Epërme, Kaçaniku i Vjetër, Koxhaj, Dubravë, Malësi, Nikë, Gllloboçicë, Runjevë, Soponicë, Stagovë, Kovaçec; dhe
- Në zonën e IV-të përfshihen këto fshatra: Sllatinë, Drenogllavë, Shtrazë, Ivajë, Kërbliq, Gjurgjedell, Kotlinë, Nikoc dhe Semajë;

3.2. Të gjitha objektet në parcelat të cilat gjinden pranë rrugës magjistrale Prishtinë – Shkup në tërë territorin e komunës dhe të cilat kanë qasje të drejtpërdrejt, si dhe ato në pjesën e rrugës regjionale Fusha e Pajtimit – Tetovë, deri te udhëkryqi për Prizren, përfshihen në zonën e I-rë.

Neni 4.

Në bazë të shqyrtimit të kontratave të shitblerjes dhe studimeve të hollësishëm të parametrave tjerë relevantë, është nxjerr vlera e tregut për të gjitha llojet e objekteve duke i klasifikuar në katër (04) zona të vlerësimit, e të cilat ndryshojnë nga viti paraprak.

Normat aplikuese sipas zonave dhe vlerës së tregut në €/m² :

	0,15%			0.20%		0,20%	0,20%	0,15%	0,15%
Zona	Shtëpi banimi	Apartment - Banesë	Garazhat	Pronat komerciale	Pronat Industriale	Pishinat	Fushat Sportive	Pronat Bujqësore	Pronat e papërfunduara
	1	2	3	4	5	6	7	8	9
I	300	300	150	700	200	140	125	100	120
II	250	300	120	500	200	125	110	80	100
III	200	-	100	360	150	110	95	60	80
IV	150	-	80	300	150	95	85	60	60

Neni 5.

Pronat të cilat lirohen nga Tatimi në Pronë, e të cilat janë të cekura në nenin 8. të Ligjit Nr. 3/L-204 - Për Tatimin në Pronën e Paluajtshme në Kosovë, lirohen nga tatimi edhe në Komunën e Kaçanikut.

Neni 6.

Shtyrja e pagesës së Tatimit në Pronë në kushte të veçanta, mund të bëhet konform të nenit 16. pika 1. të Ligjit Nr. 3/L-204 - Për Tatimin në Pronën e Paluajtshme në Kosovë

Neni 7.

Në pajtim me nenin 11 pika 1.4. të Ligjit Nr. 3/L-204 - Për Tatimin në Pronën e Paluajtshme në Kosovë - “Përgjegjësitë Komunale”, Kryetari i komunës për vitin 2013 emëron Bordin e pavarur komunal për shqyrtimin e ankesave administrative të tatim paguesve, në përbërje prej tre (03) anëtarëve.

Neni 8.

Ligji Nr. 3/L-204- Për Tatimin në Pronën e Paluajtshme në Kosovë, Ligji Nr. 04/L-100 – Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Tatimin në Pronën e Paluajtshme Nr. 03/L-204 dhe Udhëzimet Administrative, rregullojnë të gjitha çështjet tjera që kanë të bëjnë me Tatimin në Pronë, e të cilat nuk janë përfshirë në këtë rregullore komunale.

Neni 9.

Kjo Rregullore hynë në fuqi në ditën e aprovimit nga ana e Kuvendit të Komunës dhe e njëjta do të zbatohet për vitin 2013.

**Kryesuesi i Kuvendit,
z. Xhelal Gashi**